

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

nacional

Drejtor:
Mujë Buçpapaj

Adresa: **Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë**
E-mail: **nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com**

Si i njoha unë shqiptarët?

Nga **MORELLE SMITH**

Kur regjimi komunist ra, kishte kaos. Shqiptarët s'janë njerez të duruar apo të butë.

vijon në faqen 20

Gjon Milit & Pikaso

Nga **GJEKË MARINAJ**

Pasqyrimet fotografike të Gjon Milit tërheqin shikuesin drejt botës së tij të pasur artistike, një bote ku mësimi, dinamika, vendosmëria dhe transparenca nuk janë vetëm ato

vijon në faqen 10

Skender Sherifi ndër 10 autorët më të mirë të vitit 2008 në Europë

vijon në faqen 18

Majk Tajson:

Më vjen turp nga vetja

Voal-online - Ish boksiери tregon në prag të daljes së dokumentarit që flet për jetën e tij: „Jam një djalë i mirë, por mos më provokoni. Më pëlqejnë femrat e forta, por dua të dal unë gjithmonë fitimtar ndaj tyre.

vijon në faqen 23



Të legalizosh demokracinë dhe levizjen e lirë

Nga **Mujë BUÇPAPAJ**

Kur perdja e hekurt ra dhe busti i dikatorit u shemb përdhe, njerëzit parasegjitsh kishin shijuar lirinë dhe bashkë me të edhe levizjen e lirë. Një vend i çliruar shtrihej gjithandej, sido me një profil të mungesës së rregullit dhe rendit deri në kaos. Ndërsa me mijëra shqiptarë kapërcyen kufirin shtetëror për të nisur një jetë tjetër në perëndim, disa qindra mijëra të tjerë, nga më të varfërit, zbritën nga thellësitë e vendit kryesisht për në Tiranë dhe Durrës, por dhe në qytete të tjera të mëdha. **vijon në faqen 3**

Nobelisti Ferid Murati: "Jam krenar që jam shqiptar"

Krijimi i aleancave

Nga **Gani Mehmetaj**

Nuk ka shqiptar të rritur në Shqipëri, në Kosovë, Maqedoni e në diasporë që nuk e mban në mend 24 marsin e vitit 1999, mbrëmjen e asaj dite të freskët marsi, kur presidenti Klinton i paralajmëroi bombardimet e NATO-s mbi caqet serbe. Një datë që kurrë nuk do ta harrojnë shqiptarët, një veprim që kurrë nuk do t'i dalim borxhit, një kthesë historike që, përfundimisht, **vijon në faqen 3**

Mohimi, si afirmim negativ i opozitës

Nga **Arbër Ahmetaj**

Që nga viti 1991, përpjekjet për të vlerësuar dhe analizuar të shkuarën kanë kaluar nëpër një proces të vështirë. Duke lënë anash problemet e shtypit të lirë, pengesat që u bëheshin gazetarëve për të mbërritur tek burimi i informacionit, dhuna që ushtrohej ndaj tyre etj, do të theksoj një vështirësi tjetër **vijon në faqen 4**

A e kemi edhe ne Itakën tonë të fjalës publike?

Nga **Emin AZEMI**

Gjallimi njerëzor është varur nga pesha e rëndë e prezencës së njeriut në një vend të caktuar, por edhe nga një peshë tjetër, ajo e fjalës. Nga letërsia kemi shembuj të shumtë në trajtë arketipesh që tipizojnë peshën e qenies dhe të fjalës, si një simbiozë që në brendi krijon motivin për të reaguar ndaj sfiduesve të natyrave të ndryshme. **vijon në faqen 3**



Monica Beluçi tregon skretet e joshjes së saj!

faqe nr:23

Sindi Krauford 43 vjeçe si 23 vjeçe

Voal-online - Si dy herë nënë që është, ndjehet „vërtetë mirë” për pamjen e jashtme të saj. Kështu mendon topmodelja e viteve 1990 Cindy Crawford. Bukuroshja 43 vjeçare ka shpalosur trupin e saj përsëri, tashmë për revistën amerikane „Allure”, ku është fotografuar, duke qenë krenare që **faqe nr:22**

Sekretet e V.I.P.-ve Hollywood:- George Cloone, Sindi Krauford, Naomi Kempbell, Vanesa Redgreiv, Anna Nicole Smith, Klaudia Shifer

BOLERO NË VILËN

E PLEQVE

Recesion nga

Edlira Macaj

Romani nuk ka ngjarje të jashtëzakonshme e të padëgjueshme më parë, ndaj veçorinë nuk e **faqe nr:11**

Poezi e panjohur të Vilson Bolloshmit

faqe nr:19

Intervista me këngëtarët e mirënjohur

Rati & Edmond Stolia si dhe me drejtorin artistik te ansambllit "Shqiponja" **Skërder Ismaili**

Këngëtarët e preferuar te radio "Nacional" u pergjigjen fansave te tyre...

LEXONI faqe 21



Në foto Rati



Në foto Edmond Stolia

faqe nr:2...

Në BRENDËSI

Vendlindja e përfolur

Tregim nga **ZIJA ÇELA**

faqe 7

Libri i Fahri Balliut

"Zonja e Zezë Nexhmije Hoxha", bestseller ne Paris

faqe 18

KREVATI I RI

Poezi nga **Andrea Witzke Leavey**

faqe 6

RUSIANKA

Tregim nga **QAZIM D. SHEHU**

faqe 6

Tregime nga Viola Isufi, Skërder Hasko, Baardhyl Xhama

faqe 11

Poezi nga

ORHAN VELI, IDAJET BAJRI, JORGOS HRONAS, FILIPPO TOMMASO MARINETTI

LIBRAT E TIM ETI

Tregim nga **MARTIN MATO**

faqe 12-13

100 vjetori i futurizmi

Nga: **Elida BUÇPAPAJ**



Nga Gjeke Marinaj

VEPRA E GJON MILIT "PIKASO, DUKE SKICUAR HAPËSIRËN"


Pasqyrimet fotografike të Gjon Milit tërheqin shikuesin drejt botës së tij të pasur artistike, një botë ku të qenurit i ditur, dinamik, këmbëngulës dhe transparent nuk përbën vetëm disa nga impulset që artisti kërkon ndaj vetes, por edhe ato që pret prej subjekteve (humane) që fotografon. Vepra e Milit prodhon energji të brendshme dhe aftësi shprehëse të jashtëzakonshme, cilësi këto, të cilat shumica e artistëve vetëm mund t'i ëndërojnë. Vepra e tij dëshmon për një ëndërr të fuqishme artistike, për epiqendrën ku thjeshtësia dhe imagjinata ndërthuren me qëllimin për të shfrytëzuar gjuhën universale që mund ta interpretojë më mirë botën tjetër, të formësuar nga frymëzimi i bashkëpunimit midis artistit dhe disiplinës. Gjon Mili ishte një nga njerëzit e kontrasteve të mëdha, ku fotografitë bardh e zi përbënin leksione fantastike me vlerë. Ai ishte më shumë i njohur si fotograf i arteve të bukura, i cili fillimisht e nisi punën si inxhinier me diplomë nga Universiteti Teknologjik i Masaçusets, ku bashkëpunoi me Harold Edgerton, një tjetër novator në përdorimin e dritës dhe hijes. Ai kurrë nuk reshiti së eksperimentuari me metoda dhe mjete të reja: si ndezjen e stroboskopit dhe zbulimin e gjetjeve të tjera individuale në ilustrimin e elegancës së balerinëve dhe atletëve të ngritur pezull në ajër apo të ngrirë në skena të ndryshme para publikut brenda një veprë të thjeshtë të pikturës murale. Siç thuhet edhe në një nga komentet e botuesit "Aparati fotografik" (Camera), "Fotot e tij nxjerrin në pah përdorimin e elektrikut të dorës nga Mili për të përcaktuar kufijtë e emocionit dhe lëvizjes. Në çdo fotografi teknika e fotografit sa vjen dhe përsos besnikërinë e artistit" (Camera, 212). Pjesa e mëposhtme vijon nga një botim në revistën "Kina" (China) me autor R. Dubois ST. Marc:

"Pema e Sombojes ishte kthyer për fotografimin shqiptaro-amerikan Gjon Mili në pemën e dashurisë dhe frymëzimit (e cila njihet zakonisht për lulet e dashurisë dhe vdekjes). Në një nga vizitat e tij të fundit në ishullin e Indonezisë, Java, ai ishte aq i vëmendshëm nga ndërtimi i rregullt i degëve dhe ngjyrave shndritëse të luleve, sa u frymëzua nga jeta botanike e Sombojes për të shkruar në Francë dhe për t'u takuar me Pikason që të shihnin në se do ta shndërro-

nin idenë që kishin në artin e fotografisë dhe pikurës. Si pasojë bota menjëherë mund ta falënderojë pemën e Sombojes për fotografitë e Milit me Pikason i cili po luante për qejf përmes një feneri." (St. Marc, 4).

Por sikurse e dimë nuk ishte vetëm pema e Sombojes, por edhe nipi i Pikasos Javier Vilato, që i frymëzoi mendimin Milit për ta pyetur Pikason të skiconte në errësirë me një elektrik dore. Ai e realizoi këtë duke i përmendur Milit se haxhai i tij, Pikaso i kishte thënë: "Në se doni të vizatoni, duhet të mbyllni sytë dhe të këndonni" (Mili, 8). Kështu, kjo ese synon të përshkruajë, analizojë, interpretojë dhe vlerësojë pasqyrimet (shëmbëllimet) fotografike të Milit tek vepra, "Pikaso duke skicuar hapësirën", me shpresën për të mbledhur provat e mjaftueshme se Gjon Mili është më shumë se "mjeshtër i rastësive të qëllimshme," siç e ka quajtur Henry Cartier-Bresson. Gjon Mili është mjeshtër i teknikës artistike.

Mili fotografoi "Pikaso, duke skicuar hapësirën" në mars të vitit 1949. Fotoja përbëhet nga një skicë e artë prej xhelatine me përmasa afërsisht, 13 1/8 dhe 10 1/4 inç (33.5 cm me 26 cm). Fotografia është pjesë e një koleksioni më të gjerë të Milit (1904 deri 1948) që u caktua nga revista "Jeta" (Life) për të fotografuar Pikason, të cilin e paraqet në lëvizje, duke skicuar në errësirë hapësirën e zbrazët me elektrik dore. Ngjashmëritë ndërmjet shëmbëllimit të parë me elektrik dore të Pikasos, centaurit dhe formës së trupit të kërrusur në momentin e skicimit janë ndër veçantitë më



të mrekullueshme të fotografisë. Puna nga fillimi deri në fund përbën një vepër në zhvillim që i sjell kryeveprës origjinalitet dhe sinqeritet. Mili e paraqet frymëzimin e tij në ambiente pune, duke bërë atë që bën më mirë: kësaj radhe duke skicuar në hapësirë përmes një elektriku dore. Ashtu sikurse e përmend Fred Gros, "vënia në fokus për një kohë të gjatë kap lëvizjet e Pikasos si një siluete e pandërprerë dhe e lirshme përmes ndriçuesit të dorës. Skica vertikale prej dy për-

Vepra e Gjon Milit: "Pikaso, duke skicuar hapësirën"

masave e fotografisë shndërrohet më vonë në skicën e kryeveprës" (collihan.com). Shëmbëllimi e lë shikuesin të mahnitur nga dashuria me të cilën Pikaso e ka filluar skicën me çfarë mund të quhet aq sa gishti i vogël shkon përpara nga krahu i majtë, koka, brirët dhe përfundon tek krahu i djathtë, shpina dhe këmbët, duke ruajtur shpejtësinë të njëjtë, por të rrezikshme, përpiket të sjellë më tepër logjikën, se sa pamjen fizike. Kjo është e dukshme nga ndërtimi i përgjithshëm i figurës, sa që, as Mili, as Pikaso nuk mundën ta fshehin nocionin bashkëveprues gjatë punës. Këtu fotografi shqiptaro-amerikan vizaton informacionin e plotë të piktorit francez: "Ndërkohë në çast mendon se ka edhe më shumë për të punuar, merr në fotografi me shpejtësi drejt për së drejti për të mbushur format e fytyrës dhe pa e prishur lëvizjen e mbyll me nxjerrjen e fotografisë. Sa u hap aparati fotografik, shkrepja blicin. Kur Pikaso nisi vizatimin në errësirë, u bë i dallueshëm" (Mili, 16).

Vendimi i Milit për ta paraqitur Pikason si artist gjakftohtë për sa i takon pamjes karakteristike përbënte një vendim të mençur. Duke e fotografuar vetëm në pantallona të shkurtra dhe sandale plazhi, Mili në të njëjtën kohë krijon një paralele të ekuilibruar midis artit dhe artistit. Pikaso njihet për erotizmin dhe për lidhjet e tij me nudizmin. Ashtu sikurse dikush do të mund të skiconte një kostum për balerinin, vendndodhja do t'i kushtonte rëndësi formës fizike të profesionalizmit. Skenat janë njësoj, jo vetëm në lidhje me karakterin e Pikasos, por edhe me një

seriozisht. Seriozisht e kam." Pikërisht në këtë çast fotografi e takoi përmes fotografisë, "të shkrepur në errësirë, që tregon hedhjen e patinatit në lidhje me hijen që lë drita tek patinat" Sipas disa shënimeve të Milit, Pikaso u mahnit dhe i ktheu menjëherë përgjigje, duke vizatuar me gisht në hapësirën e zbrazët. (Mili, 160).

"Pikaso, duke skicuar hapësirën" është organizuar për t'i dhënë shikuesit mundësinë për t'u përfshirë me zhvillimin e mendimit të Pikasos, ndër-sa lëviz nga e majta e fotografisë në të djathtë. Sfondet janë gjithashtu të parashikuara për t'i dhënë shikuesit pamjen e rrallë të lidhjes artis-



tike që ekziston midis Milit dhe Pikasos ku secila prej tyre përbën lëmin dhe piktorin. Një shpërthim i tillë fiton edhe më shumë rëndësi si teknikë e kuptimit të zhvillimeve në marrëdhënie me atë që ekziston midis elementeve të ndryshme të fotografisë, si p.sh bashkimi i dritë hijeve të buta përmes fenerit të dorës dhe vlerat më të fuqishme të dritës së aparatit që sjellin kontraste të mëdha. I gjithë koncepti i ndërtimit harmonik në përgjithësi i shtohet fuqisë surrealistike të fotografisë duke e bërë atë edhe më të qartë se "cilësia modeste e fotografive të Milit shpesh herë merret si diçka e çuditshme, si një surrealizëm që i kanë hequr ligjet e thjeshta të kohës dhe rëndesës. Trupat rrëshqasin në hapësirë aq thellë sikur të ishin mbjellë në tokë apo sikur ta kishin kaluar kufirin me forma moderne dhe të rregullta." (Hagen). Mili krijon artistikisht më shumë se një shëmbëllim, mbi të gjitha krijon një meta-fotografi, shëmbëllimin e trupit që nxjerr shëmbëllime të trupave.

E çfarë do të mund t'i shtonim thënies së Hagenit, e cila është një thellësi e jashtëzakonshme artistike që e gjejmë në veprën "Pikaso, duke skicuar hapësirën". Kjo vërteton një forcë të njohur ndërtimore që i shërben fotografisë si metaforë me tre përmasa, duke e ndihmuar konceptin surrealist të Milit t'i shtojë forma të tjera kuptimit. Kjo është e rëndësishme në veçanti kur marrim në konsideratë se Mili e ka përfaqësuar fotografinë e tij me tre fytyra: centaurin e porsa skicuar, Pikason ende tërë gjallëri gjatë kësaj pune dhe pas tij sfondi, një dhomë e zburuar në mënyrë klasike me mure të ndërtuara rregullt dhe zburime të vjetra prej qeramike të vendo-



Viti i mbrapshtë dramë më vete

Nga: **Edlira TONUZI (MACAJ)**

BOLERO NË VILËN E PLEQVE-F. Kongoli

- Personazhi dhe gjetja e tij ekzistencial
- Pleqëria si fazë e refleksioneve dhe purifikimit spiritual
- Viti i mbrapshtë dramë më vete. Sfondi social

Romani nuk ka ngjarje të jashtëzakonshme e të padëgjueshme më parë, ndaj veçorinë nuk e ka tek ngjarjet me suspansë apo ulje e ngritje tensionesh të pikave dramatike të zhvillimit kompozicional. Ky është një roman i personazheve dhe i temave të mëdha filozofike; i jetës, i dramave të saj, i shpirtit dhe dëshirave të tij, i vdekjes dhe misterit përtej saj. Kongoli e ka dhënë këtë tablo me një përshkrim sa lakonik, aq të saktë.

- Personazhi dhe gjetja e tij ekzistencial

Që në fillim jepet makro ideja.. Romani nisët me një bisedë pragmatike duke e nisur dhe mbyllur për një dhe me një personazh femër. Harku kohor katër vjeçar është cikli për metamorfozën e qenësisë së saj. Si është raporti i qënies së saj me ekzistencën vitale? Ky është problemi estetiko-filozofik që fshihet pas këtij personazhi. Ajo do të hyjë dhe do dalë nga vila pas katër vjetësh. Shumë gjëra për të brenda këtij harku kohor pësojnë riformësime. Që në fillim personazhi rrëfimtari, një tip introvert, (Parashqevia) paraqitet e tërhequr, pasive, ndihet e dëshuar, me dëshira të shtypura dhe kujtime të dhimbshme e të fshehura, të varrosura në subkoshiençë.

Ajo është një personazh pa shumë fjalë, por me mendime të pashprehura. Rrallësia e fjalëve të saj përputhet me postraumën e pas përdhunimit. Ajo është një njeri i mendimit, i ndjeshëm, por me një koracë të jashtëme të padepërtueshme.

E kaluara e saj në çaste të caktuara i bëhet pjesë e së tashmes. E kaluara bëhet një nga shkaqet që monologët e saj para pasqyrës të jenë mendime të ndryshme dhe luftë e hapur vetëdije-nëvetëdije. Kur kjo vajzë kundërshton zërin e brendshëm para pasqyrës, ajo po

përcakton statusin e saj të ri ekzistues. Për ekzistencialistin nuk ka dashuri, përveç asaj që ndërtohet, nuk ka mundësi dashurie, përveç asaj që shfaqet në një dashuri (Dirina).

Ajo ishte një njeri vetmitar. Shumë njerëz janë mësuar kaq shumë të jenë vetëm, sa që e kalojnë jetën e tyre në bashkëbisedim me vetveten. Ata priren nga një nënvlerësim ndaj vetes, aq sa duhet të rimësojnë prej të tjerëve një opinion të mirë e të drejtë mbi veten e tyre... (Niçe). Ndaj kjo vajzë, kur zbulon misterin Buster Keaton, që është shumë i bukur, por gjithnjë i shoqëruar nga pamja e tij melankolike, rimëson të vlerësojë veten e saj.

Prania e tjetrit është po aq e domosdoshme për të. Njohja e saj e vetvetes zbulon edhe tjetrin për të zbuluar intersubjektivitetin së ç'është ajo dhe ç'janë të tjerët. Ajo zgjedh vetveten sipas rrethanave dhe zgjedhjet e saj nuk janë rastësore.

Për të paraja nuk ka aq shumë vlerë, sa vetë beson se punën në vilë e pranon për shkak të ndjesisë pozitive ndaj një figure femërore.

Bota e saj është bota e një femre me një të kaluar të dhimbshme, por me ndjeshmëri ndaj së bukurës. Të qenit vetvetja ka paguar koston e shtrenjtë, përdhunimin. Personazhi zbulohet ngadalë. Që në fillim nuhatet dicka që nuk shkon. Jeta e saj është një rutinë e pagjasshme me atë të të tjerëve. Ajo merr frymë, por nuk jeton, ose jeton pjesërisht me fantazmat e së shkuarës.

Kjo është figura më e veçantë femërore në letërsinë e këtyre viteve. Një vajzë me tipare mashkullore, që brenda saj ka një shpirt të ndjeshëm dhe mund të dashurojë pa komplekse. Ajo është tepër njerëzore. Në fund të fundit është një përpjekje për të gjetur përgjigjet për ekzistencën e saj në të vërtetë.

Tek ajo gjenden keqardhja për pleqtë, irritimi, acarimi, mëshira etj. Ajo rreket të provojë ndjesi. Tek kjo femër ka vend ndjenja për të dashuruar një femër, ka vend vullneti për të mos përbuzur seksin mashkull dhe triumfon forca për të vazhduar jetën, ndryshe nga më parë, qoftë edhe duke e ndarë vetminë me një qenie të gjallë në fund të romanit. Ky personazh ka karakteristikën thelbësore ekzistencialiste, të vihet në zotërim të asaj që është dhe të marrë përgjegjësinë e plotë për ekzistencën e vetvetes.

Në fund rezultatja është një figurë shumë njerëzore, që përlligj shprehjen: *Edhe engjëlli dhe djalli janë brenda tek i gjalli.*

- Pleqëria si fazë e refleksioneve dhe purifikimit spiritual

Kongoli ndalet në një pjesë të jetës njerëzore, të cilën pak shkrimtarë do të parapëlqenin ta kishin subjekt tyrin, pleqërinë. Është një moment jetësor që nuk preket shpesh, pasi nuk ngjall emocione të forta siç mund të jenë pasazhet jetësore të një të riu. Ai arrin të bëjë të pëlqyeshme një pjesë pasive e problematike të jetës njerëzore. Mënyra se si ai e paraqit është thelbi i suksesit të romanit.

Kjo pleqëri dhe sëmundja shoqëruese e saj bëhet boshti lidhës i këtij makrorrëfimi. Misteri i letrave të dy të bashkëshortëve vazhdon deri në fund. Ky çift, dikur i bukur dhe i dashuruar me njëri tjetrin, vazhdon deri në fund një lojë dashurie që vetëm ata ia dinë kuptimin. Shprehja e heshtja e Firdusit, si një krijesë e një kohe tjetër, të bën ta perceptosh me një shqisë të veçantë këtë grua të moshuar. Raporti i tyre është specifik; dy njerëz që po shuhën pranë njëri tjetrit. *Ne vetë jemi rastësi të papërsëritshme f. 175*

Ata janë si dy adoleshentë që grinden e kuptohen me mënyrën e tyre. Raporti i tyre del aq komik, po aq edhe i dhimbshëm, se jo më kot lidhja e tyre shpirtërore janë tingujt e Bolero-s së Ravelit, si një ndër pjesët muzikore më popullore, e cila ka në strukturën e saj kryesisht instrumentale çift; dy flautë, dy oboe, që quhen oboet e dashurisë, dy saksofonë, etj. Bolero njihet botërisht se ritmin e saj e ka te njëjtë me ritmin e ndërveprimit seksual. (A.Bloom)

Në raportin komunikativ të pleqve *fantazma* Firdus bëhet prani e cila përcakton në njëfarë mënyrë evolucionin e komunikimit mes plakut dhe vajzës në një nivel tjetër. Rrëfimi fantastik për fantazmën bën përcaktuese lidhjen e plakut me pjesë të tjera të udhëtimit të tij në fazën e fundit të jetës. Pasqyrimet e herëpashershme mbajnë një konstante. Tema madhore e vdekjes jepet si një proces i natyrshëm, por i pashmangshëm. Historia e tyre e parëndësishme për të tjerët, përjetohet ndryshe nga Parashqevia. Kjo është një logjikë e përlligjshme. Ndodh që jeta të sjellë pranë njerëz të panjohur në rrethana jo aq të tilla, që të mund të përcaktojnë lidhjen ose distancën nga këta njerëz. Afria të lidh dhe të butëson emocionet. Periudha e vetmuar nuk të çudit, kur në fund të jetës së Firdusit, Parashqevia e thërret nënë. Në një farë mënyrë ajo sublimon ndjenjën amësove tek ajo.

Këtu fillon edhe thyerja e saj emocionale.



Rrëfimi në roman është pa kurthe narrative, i pastër. Fjalja lehtësisht e kuptueshme.

Çështja të tjera si: paraja, adulteri(doktori), objekti social janë në sfond, por jo të parëndësishme. Ato janë të sfumuar në raport me imtësitë e botës së brendshme të personazhit vetmitar.

- Viti i mbrapshtë dramë më vete

Me qëllim që të tregohet si histori paralele dhe të shpjgohet qartësisht figura e Parashqevisë jepet edhe pjesa e viteve të dhimbshme të jetës së saj. Shqipëria e 97-tës është Shqipëria e egërsisë së madhe ku shteti është inekzistent.

Vështrohet herë pas here nga e shkuara si për të kërkuar motivimin e një sekretit thelbësor. E kaluara bëhet pjesë tematike më vete.

Panorama sociale si vit i mbrapshtë është edhe shkaktar i kompleksit dhe karakterit flegmatik i personazhit, sepse ajo mbart me veten drama personale dhe sociale.

Digresionet, po ti shkëputësh si ndërkalje, kanë një strukturë dhe linjë më vete. Linja e egërsisë dhe barbarisë që mbyl brishtësinë dhe lirinë apo parapëlqimet individuale.

FUND

surja njëra mbi tjetrën në dy mbajtëse prej druri.

Vlera e veprës "Pikaso duke skicuar hapësirën", bëri që shumë studiues të dalin nga format e tyre artistike për t'u bashkuar me Milin. Njëri prej tyre është Peter Robert Prifti, "Isha vërtetë i prekur nga realiteti i tij për sa i përket ushtrimit të teknikës e cila edhe një herë më risolli arsyt për të besuar se kjo veper kishte ndikuar në brezin e tij siç ishte p.sh Xhekson Polok (Jackson Pollock) që më parë përshkruante veprën e Milit: 'energji dhe lëvizje e dukshme.' Ndaj zbulova se ishin idetë e ngjashme të vëna në përdorim në veprën "Pikaso duke skicuar hapësirën" për të cilën kërkoja ta pyesja" (Prifti). Më vonë shohim fotografitë e Hans Namuthit (Hans Namuth) nga Xhekson

Pollock (Jackson Pollock) që vërtetojnë punën e artistit përpara aparatit fotografik. Në të vërtetë kjo fotografi është tepër e veçantë për sa i takon ndërthurjes vizuale, po aq sa edhe natyrës në lidhje me veprën e brezit të tij, si p.sh Pollok dhe shumë artistë të tjerë bashkëkohorë, ku betimi i artistit shpreh jo drejt për së drejtë rolin e Milit tek Stuart Allen:

"Për një kohë të gjatë, kam qenë duke bërë fotografi nga hijet që linte elektriku i dorës. Kjo teknikë nisi si pasojë e një pune të mëparshme e cila merrej me lëvizjen e ajrit. Në koleksionin e veprave "Konturet e Natës" pasqyrohet gjuha ime me hapësirat e fotografuara. Duke i kaluar nga prapa aparatit fotografik, ndryshon edhe rolin, nga shikues në bashkëpunëtor. Në shumicën e rasteve teknikat u bash-

kuan me vendndodhjen se sa me pararendimin. Si pasojë figurat vërtetuan pikësynimin tim për vendin dhe në një farë mënyrë u shndërruan në autoportrete. Edhe pse koleksionet nisën me qëllimin për të kapur lëvizjen e ujit në vendndodhje, si përfundim pjekuria ime personale u bë materiali kryesor i veprës" (Allen).

Figura i jep jetë fotos së çastit emocional, personal, dhe të drejt për drejtë si një nga fokuset e dhura për fotografinë dhe figurën e plotë që përbën pikësynimin e vetëm të artit. Pasi emocionet shprehen nga të dyja palët, si nga fotografi ashtu edhe nga brendësia në të njëjtën kohë, përfundimi kalon drejt një figure të vetme njëkohësisht si për shikuesin. Pasoja është një lojë shëmbëlltore që vërteton se autori i revistës "Time" (Koha), Timothy Foote, thotë

për Milin se: "ai revolucionarizoi artin e tij dhe ndikoi tek dy brezat e gazetarëve" (Foote). Përveç kësaj në sfond dalin tiparet karakteristike të cilat sjellin qëllimin e planifikuar për të përdorur artin tradicional të qeramiks (terakotës) si teknikë zbukurimi në materialet pamore dhe logjike, pa tërhequr vëmendjen e shikuesit nga ndriçimi didaktik i së ardhmes mbi teknikën krijuese të Pikasos. Të dyja format e artit, si fotografia ashtu edhe vizatimi, mbushin hapësirën me lëvizje, trajtë, ndriçim dhe simetri. Ndaj mund ta interpretojmë shëmbëlltoren në përgjithësi si një pasqyrë që pasqyron natyrën e ndërlikuar të artistëve tërë pasion, kundërshtime dhe cilësi artistike mahnitëse. Ndërkohë vetë Pikasoja zbuloi idenë e kuptimit të skicës që ndikon drejt për së drejtë në riformimin e shikuesit: "Fotografia nuk është bluarja

e mendimit dhe modifikimi i saj më parë. Ndërsa merret fotografia, ajo ndryshon ashtu sikurse ndryshojnë mendimet. Ndërsa ajo është marrë, ende vazhdon e ndryshon, sipas gjendjes mendore të atij që është duke e parë. Një fotografi jeton vetëm tek personi që është duke e parë." (Pablo Pikaso, 9). Fotografi mund ta bluarë në mendjen e tij dhe ta modifikojë atë më parë, ku gjithsesi më së fundi në veprën "Pikaso duke skicuar hapësirën" vërteton edhe një herë origjinalitetin e asaj që thuhet.

Edhe pse artistët nuk konsiderohen gjithmonë të jenë kritikët më të mirë të veprave të tyre, ne shikuesit, kemi fatin e mirë të kuptojmë se cili ka qenë qëllimi i autorit gjatë krijimit të kryeveprës "Pikaso duke skicuar hapësirën".

Një sukses mbresëlënës në libraritë e Parisit


Mediatori i Francës (Avokati i Popullit) Jean-Paul Delavoye dhe shtëpia botuese "Favre" kanë promovuar në Paris librin "La Femme du diable", edicionin në frëngjisht të publicistit Fahri Balliu.

Zoti Delavoye i akordon zotit Balliu edhe dekoratën "për kontribut të shquar në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut"

Ditë më parë, në Paris, në mjediset e Mediatorit të Republikës së Francës (Avokatit të Popullit), ky institucion i rëndësishëm i republikës franceze dhe Enti i njohur botues franko-zviceran "Favre" organizuan promovimin e librit "La femme du diable - Gruaja e djallit", edicioni frëngjisht i librit best-seller të Fahri Balliut në libraritë shqiptare "Zonja e zezë Nexhmije Hoxha". Në ceremoni morën pjesë personalitete të jetës publike në Francë, publicistë, njerëz të librit si dhe përfaqësues të komunitetit shqiptar aty. Merrte pjesë ambasadori i Shqipërisë në Paris Ylljet Aliçkaj si dhe Geneviève Garrigos, Présidente e Amnesty France, degës së prestigjiozes "Amnesty International".

Në fjalën e tij prezantuese, Mediatori i Francës, Jean-Paul Delevoye u ndal në kontributin që jepte përkthimi i librit në frëngjisht, në mënyrë që publiku francez e ai evropian të kuptonte më

Promovohet në Paris monografia best-seller e Fahri Balliut "Zonja e zezë Nexhmije Hoxha"



mirë shkeljen brutale të të drejtave të njeriut në Shqipërinë komuniste, në një rën nga diktaturat më të egra në Evropë.

Në emër të qeverisë shqiptare, ceremoninë e ka përshëndetur zv/ministri i Arsimit

dhe Shkencës Halit Shamata, i cili u ndal kryesisht në rëndësinë e përkthimit dhe të publikimit në frëngjisht të monografisë "Zonja e zezë Nexhmije Hoxha". Vetë autori i librit, zoti Fahri Balliu, në përshëndetjen e vet ka falenderuar

Mediatorin e Francës për ceremoninë, shtëpinë botuese "Favre" për publikimin e librit, i cili po njih një sukses mbresëlënës në libraritë e Parisit, si dhe përkthyesin e veprës, për kontributin në përcjelljen besnike të ndjesisë së

papërsëritshme që provojnë shqiptarët, sa herë flitet për bashkëshorten e diktatorit

Hoxha, e cila sot e kësaj dite është avokatja më e rëndësishme e diktaturës dhe s'lodhet së bëri apologjinë për regjimin më antikombëtar që kanë provuar shqiptarët në historinë e tyre.

Në përfundim të ceremonisë, Mediatori i Francës, zoti Delevoye e dekoroi zotit Fahri Balliu me një dekoratë mirënjohjeje "për kontributin e dhënë në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, përmes aktivitetit të tij letrar e publicistik, si dhe për publikimin në frëngjisht të veprës 'La femme du diable', me të cilën lexuesit francezë u njohën edhe më tej me brutalitetin e regjimit komunist në Shqipëri". Ceremonia zgjoi interesin e mediave më të rëndësishme franceze, si Le Figaro, Le Point, Le Monde e Liberation, të cilat përcollën korrespondenca nga promovimi i librit në frëngjisht. Monografia "Zonja e zezë Nexhmije Hoxha" është publikuar më herët në anglisht e maqedonisht, ndërkohë që është në proces përkthimi e botimi edhe në disa gjuhë të tjera të rëndësishme të komunitetit evropian.

Nga Halil RAMA

(vijon nga faja 11)

Ashtu sikurse lexojmë edhe në librin e tij, Mili synonte që natyra e Pikasos të lidhej më shumë me nocionin e përgjithshëm të mendjes së tij se sa me çastin e veprimit. Në këtë aspekt, fotografia e bind shikuesin se vetëm Mili ishte duke u përqendruar në këtë punë. Nëse do të na duhej të besonim poetin francez, "të shohësh do të thotë të kuptosh, gjykos, prishësh, imagjinosh, harrosh, apo edhe të mohosh vetveten, të ekzistosh, apo edhe të mos jesh," (Eluard, 9), për të cilën gjithashtu mund të mendojmë se në veprën "Pikasa, duke skicuuar hapësirën" ajo përbente një sukses.

Bashkimi i pjesëve origjinale si përmasat, trupi i centaurit dhe siluetat e lehta të skicuara me dorë dhe përmasat natyrale mirë veprojnë në dallim me trajtat gjeometrike të kolonave të vendosura vertikalisht me sfondin. Duke iu shmangur teknikave tradicionale të portretizimit dhe zbatimit të teknikave të reja të shumëllojshme, ku po të për-

bledhim fotografinë e njohur të Pikasos, konsiderohet si "fotoja e një gjeniu të frytshëm dhe veprues" (Hagen), e cila e fton shikuesin drejt një universi artistik unikal të urdhëruar nga një fotograf i talentuar dhe piktor gjenial.

Pas një studimi të imtë të veprës së Gjon Milit, bie dakord me komentet e Zhan Pol Sartrit (Jean-Paul Sartre) për karakterin e Milit si artist, (Satre morri çmimin Nobel për Letërsi në vitin 1964). Pasi përshkruan tiparet fizike të Milit dhe jetën personale si të përshatshme për të qenë fotograf i suksesshëm, Sartre komenton mbi teknikën profesionale të Milit:

"... Ai nuk ka për qëllim t'ju vrasë, për më tepër ai kërkon t'ju kapë të gjallë. Madje edhe fotografitë e tij më të mira nuk janë më shumë se trupa të balsamosur, të ruajtur nga hiposulfati, ndërsa qenia juaj e vërtetë është gjithnjë e më shumë në ndryshim nga forca e përjetësisë. Por Mili të kap të gjallë ashtu siç je, të gjithin, të papërpunuar dhe në fotografi duket sikur je duke luftuar me vetvet-

en, si peshku i zënë në rrjetë. Mili del robëruesi i njerëzve. Ai është në çdo sjellje tërë marifete, që të nxjerrin jashtë kontrollit.

Ai nuk është vetëm i kënaqur për të marrë në fotografi figurat e njohura, por i bën çdo fotografi një provë, një hije. Për të ekzistojnë shumë mënyra të fotografimit, po aq sa ka edhe njerëz. Nëse do t'ju bënte pjesë të koleksionit të tij, ai jo vetëm që do t'ju fiksonte ashtu siç ishit në të vërtetë dhe në formë të çrregullt për modelin e skenës, por përveç kësaj do t'ju vëzhgonte e vëzhgonte" (Mili, 8).

Për ta mbyllur shkurtimisht historinë, Mili ndërthur talentin me parashikimin dhe devijon kufirin e supozuar midis fotografisë dramatike dhe të drejt për drejtë. Kështu pra, në këtë mënyrë dhe në të njëjtën kohë përmes pranimit të bashkëpunimit dhe rrisë teknike në vepër me dritën dhe lëvizjet, ai shndërron në artistin që tejkalon kufijtë e vendosur nga brezi i tij i artistëve.

GAZETA BELGE "LA LIBRE BELGIQUE", PËRZGJEDH LIBRIN LOVE TË POETIT SHQIPTAR. Skender Sherifi ndër 10 autorët më të mirë të vitit 2008 në Belgjikë

Sipas redaksisë kulturore dhe kritikes vendase, libri i Sherfit ka konkuruar në gjitha zhanrat e librave që janë publikuar në gjuhën frënge në Belgjikë nga gjitha shtetet e botes, e sidomos asaj frankofone.



Libri LOVE i poetit shqiptar Skender Sherifi klasifikohet ndër 10 librat më të mirë të vitit 2008 në Belgjikë. Kjo është njoftuar nga gazeta "LA LIBRE BELGIQUE" në numrin e saj të 26 dhjetorit të vitit 2008. Sipas redaksisë kulturore dhe kritikes vendase, libri i Sherfit ka konkuruar në gjitha zhanrat e librave që janë publikuar në gjuhën frënge Belgjike (roman, novelë, tregim, biografi, poezi, ese, libra të vizatuar etj ...) nga gjitha shtetet e botes, e sidomos asaj frankofone, Belgjikë-Francë-Zvicer. Gazeta në mës të

tjerave deklaroi se sipas një përzgjedhje bazuar në shijet dhe kriteret personale të gazetareve të kulturës: libri LOVE figuron në 10 librat më të mirë të vitit 2008 në Belgjikë.

Ky mund të konsiderohet si një sukses domethënës i letërsisë shqiptare, pasi Skender Sherfi shkruan edhe boton edhe në shqip.

